



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:073262

Datë: 11.07.2023

Numri i dokumentit: 04474377

SCC-11-0143

Paditësi; S D nga Klina

Kundër

Pala e paditur: Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, rruga „Dritan Hoxha ” nr.55-Lakrishtë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën; 11.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Pezullohet procedura në këtë çështje juridike kontestimore të paditësit S D, për shkak se K U është në procedurë të likuidimit..

A r s y e t i m i

Rrjedha procedurale dhe faktike e çështjes

Paditësi Sefer Desku me datën 11.05.2011, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Në padi ndër të tjera ka theksuar se në vitin 2006 ka marrë autorizim nga Drejtori i K U në cilësi të avokatit për të paditur I F A nga Komuna e Klinës për dorëzimin e sendeve të paluajtshme dhe kompensimin për shfrytëzimin e tyre dhe se e ka përfaqësuar në Gjykatën Komunale në Klinë. Me rastin e përfaqësimit i ka mbrojtur interesat e kooperativës nga uzurpimet e paligjshme të personave privat. Në bazë të marrëveshjes pas shitjes së aseteve të ndërmarrjes shoqërore do të paguheshin edhe shpenzimet e përfaqësimit.

Me tutje në padinë e parashtruar ka theksuar se sipas autorizimit i cili gjendet në shkresat e lëndës të Gjykatës Komunale në Klinë ka ushtruar padi ndaj të paditurit S Z Rr për pagesën e qirasë për shfrytëzimin e tokës së kësaj ndërmarrje dhe të njëjtën e ka përfaqësuar në gjykatë. Në emër të këtyre shërbimeve të kryera pala e paditur i ka mbetur në borxh në shumën prej 1,000.00 €, andaj i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të shkresave të lëndës kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar. Me parashtrësën e datës 18.05.2023, paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë ku i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të provave të lëndës kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar dhe të detyrohet pala e paditur që t'ia kompensoj shumën prej 1,030.00 €, me normë të kamatës në shkallën prej 8 % në vit e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padiisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.

Pala e paditur me përgjigje në padi i ka kontestuar pretendimet e parashtruara nga pala paditëse në padi duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. Ka theksuar se K U me vendimin e Bordit të Drejtorëve ka shkuar në procedurë të likuidimit. Në bazë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit me nr.04/L-034, për Agjencinë, çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshinë apo që është kundër një ndërmarrje e që është subjekt i vendimit të likuidimit pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të vendimit për likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që procedura të pezullohet derisa ndërmarrja është në procedurë të likuidimit.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 10 të Shtojcës së Ligjit me nr.04/L-034, për Agjencinë, çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshinë apo që është kundër një ndërmarrje e që është subjekt i vendimit të likuidimit pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të vendimit për likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit. Në rastin konkret nga provat e shqyrtuara parashtrimet dhe pretendimet e palëve në procedurë gjykata ka konstatuar se me vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 16.12.2013, pala e paditur ka filluar procedurën e likuidimit të ndërmarrjes.

Rrjedhimisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara me lartë e po ashtu nga gjendja faktike e konstatuar nga shkresat e lëndës gjykata ka ardhur në përfundimin se janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës në këtë çështje juridike kontestimore, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit kohor prej; 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit i këtij aktvendimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi